



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.2020

“PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË  
LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006, ‘PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE’, TË  
NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve: 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të  
Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave;

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006,  
‘Për sistemin e taksave vendore’, të ndryshuar”, për shqyrtim e miratim në Kuvendin e  
Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DËNAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, 2020

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006, ‘PËR  
SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të  
Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto  
ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 10, paragrafi i parë i, zëvendësohet me këtë përmbajtje:

*“Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më  
i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimeve të  
parashikuara në këtë kre.”*

Neni 2

Neni 11 ndryshon me këtë përmbajtje:

*“Neni 11*

*Shkalla tatimore*

*Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen  
tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8  
(tetë) milionë lekë, është 0 (zero).”*

Neni 3

Në nenin 15 "Parapagimi" shfuqizohet.

#### Neni 4

Neni 16 "Deklarimi" ndryshon me këtë përmbajtje:

*"Çdo tatimpagues, objekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore."*

#### Neni 5

Në nenin 17 "Administrimi i tatimit", paragrafi i parë ndryshon me këtë përmbajtje:

*"Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël."*

#### Neni 6

Neni 18 'Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njërive të qeverisjes vendore dhe në buxhetin e shtetit dhe komisioni i agjentit tatimor' dhe neni 19 'Bashkëpunimi', shfuqizohen.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2021.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUCI

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006,  
‘PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE’, TË NDRYSHUAR”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Propozimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, të ndryshuar”, të ndryshuar është mbështetur në nenet 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Situata me të cilën po përballet vendi ynë, si rezultat i epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, e ka bërë të nevojshme krijimin e një kuadri ligjor lehtësues për atë tatimpagues të cilët përballen me vështirësitë më të mëdha nga kjo situatë. Për këtë qëllim Qeveria Shqiptare është përpjekur maksimalisht të krijojë mundësinë për lehtësimin e kostove për bizneset duke ndërmarrë iniciativa ligjore me qëllim arritjen e këtij objekti.

Propozimi i këtij projektligji vjen në vijim të aktit normativ nr.19, datë 23.04.2020, në kuadër të të cilit u zeruan pagesat e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të vitit 2020 për të gjithë subjektet objekt i këtij tatimi. Nëpërmjet kësaj politike u synua mbështetja e bizneseve të vogla në drejtim të likuiditetit të disponueshëm.

Ndërkohë në kuadër të politikave fiskale që vlerësohet të ndërrmerren më tej, synohet të propozohen ndryshime në shkallën tatimore të aplikuar për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.

Për këtë qëllim ky projektligji synon:

- Realizimin e reformave të mëtejshme të ndërmarra së fundmi nga qeveria në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19;
- Lehtësimin e barrës fiskale të asaj kategorie biznesi e cila konsiderohet me vulnerabël ndaj situatës të vështirë financiare të krijuar nga COVID-19, nëpërmjet zerimit të shkallës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

---

Relacion shpjegues për Projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, të ndryshuar”

Ky amendim nuk është parashikuar në programin analitik të projekt-akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, ndërkohë sqarohet se, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) 2020, janë propozuar amendime të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, në kuadër të paketës fiskale 2021.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Vitet e fundit janë ndërmarrë reforma të rëndësishme përsa i përket tatimit mbi fitimin dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

- Nga data 1 janar 2014, biznesit të vogël, (tatimpaguesit me qarkullim nën 8 milion lekë) iu përgjysmua tatimi mbi fitimin në 7,5% në krahasim me biznesin e madh (tatimpaguesit me qarkullim mbi 8 milion lekë), për të cilët norma tatimore u bë 15%. Tatimpaguesit me qarkullim nga zero në 2 milionë lekë paguanin një tatim fiks prej 25 mijë lekë në vit.
- Nga data 1 janar 2016, u propozua të thellohet kjo ulje, me një normë tatimi prej vetëm 5%, për tatimpaguesit nga 5 milion deri në 8 milion lekë, ndërsa për tatimpaguesit me qarkullim nën 5 milion lekë, tatim fitimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël u bë zero.

Aktualisht subjektet me qarkullim nën 8 milion lekë, të cilat janë subjekt i ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël sipas shkallës tatimore të përcaktuar në nenin 11 të ligjit nr.9632/2006, dhe konkretisht:

- Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5 për qind.
- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.

Me anë të këtij projektligji propozohet që tatimpaguesit objekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim, deri në 8 milion leke të mos taten, pra norma e tatim fitimit të jetë në shkallën 0%. Nga kjo lehtësi fiskale do të përfitojnë rreth 5311 subjekte.

#### IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës.

#### V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE).

Projektligji nuk synon përafrimin me Acquis Communautaire.

#### VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT.

Ky projektligj përbëhet nga 7 nene.

Në nenin 1, të projektaktit, parashikohet se çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimeve si objekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

Neni 2, parashikon se shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero) për qind.

Neni 3, parashikon shfuqizimin e nenit 15 “parapagimi”.

Neni 4, parashikon se, “Çdo tatimpagues, objekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.

Neni 5, përcakton se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Neni 6, përcakton se, neni 18 ‘Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njërive të qeverisjes vendore dhe në buxhetin e shtetit dhe komisioni i agentit tatimor’ dhe neni 19 ‘Bashkëpunimi’, shfuqizohen.

Neni 7, parashikon se, ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2021.

#### VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

---

Relacion shpjegues për Projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, të ndryshuar”

Për zbatimin e këtij projektligji, ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

#### VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka draftuar projektligjin. Projektligji i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministrit të Shtetit për Rindërtim, Ministrisë së Brendshme dhe për dijeni Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Ministria e Drejtësisë dhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes u shprehën dakord me projektligjin. Ministrit i Shtetit për rindërtimin u shpreh pa komente për projektaktin, ndërsa Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin nuk u shpreh duke qenë se është për dijeni. Ministria e Brendshme nuk ka paraqitur mendim, megjithëse afati për dërgimin e mendimit ka qenë në datën 08 Korrik 2020.

#### IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet në buxhetin e shtetit nga parashikimet e këtij projektligji vlerësohen përafërsisht në masën -400 milionë lekë në vit, referuar të ardhurave të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2019 dhe rreth 5311 subjekte përfitojnë nga parashikimi i projektligjit.

MINISTËR

Anila Denaj